



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:044135

Datë: 12.03.2024

Numri i dokumentit: 05442344

KA.nr.306/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ të paditësit “Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike” ShA me seli në bulevardin Bill Klinton nr.5 në Prishtinë, kundër të paditurit Zyrës së Rregullatorit për Energji me seli në rrugën Bekim Fehmiu, kati II, p.nr. në Prishtinë, objekti i kontesti anulimi i aktit administrativ, pas seancës publike të shqyrtimit kryesor të datës 26.02.2023 në të cilën morën pjesë të gjitha palët dhe përfaqësuesit e tyre, më 1 mars 2024 dha këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit “Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike” ShA ndaj të paditurit Zyrës së Rregullatorit për Energji me të cilën ka kërkuar anulimin e aktit administrativ V_1234_2020 të datës 12.02.2020 të Bordit të së paditurit.

A R S Y E T I M

I. Padia, kërkesëpadia dhe pretendimet e palëve

1. Paditësi përmes padisë së datës 04.04.2020 e ka iniciuar konfliktin administrativ me kërkesë për anulimin e aktit administrativ V_1234_2020 të datës 12.02.2020 të Bordit të së Paditurit. Ai në padi por edhe gjatë seancës për shqyrtimin e kryesore të çështjes ka pretenduar se akti administrativ i goditur është i pa bazë dhe jo i ligjshëm sepse ekipet e KEDS më 26.03.2015 përmes procesverbalit 0390506 kishin konstatuar se njëtori nr. 39360867 ishte i lidhur në rrjetin elektrik pa pëlqim elektro energjetik dhe njëherësh kishin evidentuar edhe shpenzimet e bëra për 4503 kWh. Sipas tij, përderisa objekti ndërtimor nuk ka qenë i pajisur me pëlqim nga KEDS për kyçe në rrjet, rrjedhimisht që të gjithë njëtorët e kyçur dhe e gjithë energjia e shpenzuar ka qenë

ilegale, prandaj nuk ka qenë i mundur faturimi i shpenzimeve deri sa objekti teknikisht nuk ka qenë në rregull. Ka shtuar se po sa është dhënë pëlqimi nga KEDS për objektin e banimit kolektiv, atëherë njësorët e vendosur nga vet konsumatorët të cilët janë hasur në momentin e pranimi dhe pas hapjes së shifrës së konsumatorit është bërë faturimi i shpenzimit. Ngjashëm edhe për konsumatorin e njësorit nr. 39360867, L.B., të cilit i është legalizuar kyçja në atë njësor dhe i janë faturuar shpenzimet që ka pas gjatë kohës kur ka qenë i kyçur pa pëlqim, prandaj shpenzimi i faturës kontestuese nuk ka të bëjë vetëm me shpenzimet e një muaji, por përfshin shpenzimet të cilat konsumatori i ka bërë edhe gjatë kohës kur ka qenë i kyçur pa pasur pëlqim. Ka shtuar se gjendja e shpenzimeve të energjisë elektrike me njehsorin e konsumatorit në fjalë ka qenë e verifikuar nga ekipet e tij qysh më 27.03.2015, pra në kohën në të cilën konsumatori ka qanë i kyçur në rrjet pa pasur fare pëlqimin elektro energjetik. Sipas tij, arsyetimet e të Paditurit se konsumatori nuk ka pasur mundësi të shpenzoj kaq KW për periudhën kontestuese nuk mund të merret si i bazuar pasi që konsumatori ka qenë i kyçur rreth 1 vit më herët se sa koha kur i është dorëzuar fatura kontestuese. Përveç kësaj, Paditësi ka deklaruar se më 20.02.2017 e kishte refuzuar ankesën e konsumatorit L.B., i cili ka pasur të drejtë ankese brenda 14 ditëve sipas nenit 13 para. 1 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe të Kontesteve në Sektorin e Energjisë, ndërsa ai e ka parashtruar ankesën e tij më 23.08.2017 ose 5 muaj pas afatit, rrjedhimisht ankesa është dashur të hedhet poshtë si e pasafatshme. Për fund ka deklaruar se pas dhënies së PEE-së dhe legalizimit të njehsorëve dihet se prej cilit njehsor elektrik është furnizuar konsumatori L.B. dhe kjo nuk është kontestuar as nga vet konsumatori.

2. I padituri në përgjigje e tij në padi dhe gjatë gjithë procedurës e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e Paditësit dhe i ka kërkuar gjykatës që ta refuzoj atë si të pabazuar. Ia ka deklaruar se vendimi është i bazuar në nenin 14, 17, dhe 18 të Rregullores për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, si dhe nenit 15 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë. Më pastaj e ka përshkruar rrjedhën e procedurës deri në dhënien e aktit administrativ të kontestuar, dhe ka shtuar se njëtori nr. 39360867 fillimisht ishte i evidentuar se njëtori i kyçur në mënyrë të kundërligjshme pa e specifikuar se cilën banesë e furnizon, ndërsa në procesverbalin nr. 0589585 të datës 10.05.2016 për ndërrimit të njëtorit është shënuar se konsumatori nuk e prezanton atë njëtori me nr. 39360867, kurse në procesverbalin nr. 0607728 të datës 10.05.2016 konsumatorit L.B. i hiqet njëtori nr. 39700119 dhe i montohet njëtori i kontestuar nr.

39360867, gjë që i bënë kundërthënës këta procesverbale. Ka shtuar se Paditësi nuk ka mundur tua faturoj personave energjinë elektrike, të cilat janë kyçur në mënyrë ilegale në rrjetin eklektik, por është dashur që ta ndjek procedurën për parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike. Sipas tij, Paditësi ka bërë shkelje edhe të nenit 28 para. 1 dhe 2 të Rregullores për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, si dhe nuk ka ofruar prova nga të cilat do të vërtetohej se akti administrativ i goditur është i kundërligjshëm. Lidhur me afatshmërinë e ankesës ka deklaruar se kjo çështje nuk ishte ngritur nga Paditësi pasi ZRRE kishte nxjerr vendimin e shkallës së parë në kundërshtimin e parashtruar prej këtyre ndaj këtij vendimi, rrjedhimisht as bordi i ZRRE-së nuk e ka shqyrtuar këtë çështje. Për fund ka shtuar se, shpenzimi i energjisë elektrike për periudhën 05-2016 prej 9166 KW nuk paraqet shpenzime real mujor, por paraqet grumbullim të shpenzimit të muajve paraparak dhe nëse pjesëtohet me mesataren e shpenzimit prej rreth 1000 KW orë në muaj ka rezultuar që konsumatori ka mund të jetë i kyçur për rreth 8 muaj para periudhës së kyçur në mënyrë legale.

II. Provat e administruara dhe gjendja faktike e konstatuar

- Me qëllim të konstatimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata i aprovoi të gjitha propozimet e palëve për administrimin e prova. Në këtë drejtim, në seancën për shqyrtimin kryesor u administruan provat si në vijim: Vendimi i bordit të ZRRE-së nr. V_1234_2020 i datës 12.02.2020; vendimi ZRRE/DMK_V_2013_12_19 i datës 17.12.2019; procesverbal mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit me numër serik 0589585 i datës 10.05.2016; procesverbal mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit me numër serik 0607728 i datës 10.05.20216; procesverbali nr. 0390506 i datës 26.03.2015; Rrjedhja e njësorit Energjia Elektrike DPR-...; formulari i ankesës së konsumatorit me numër 101126, dhe korrigjimi në emër të L.B. për njehsorin 39700119, gjegjësisht për anulimin faturës për muajin 07-2016 në bazë të njehsorit elektrik 39360867.
- Në bazë këtyre provave gjykata konstaton se Paditësi më 26.03.2015 kishte vërejtura se në objektin e banimit kolektiv në rrugën Holger Peterson në Prishtinë kishte pasur disa kyçje ilegale në rrjetin elektroenergjetik, në mesin e tyre edhe njësori nr. 39360867. Lidhur me këto gjetje Paditësi në të njëjtën datë e kishte përpiluar procesverbalin nr. 03990505, në të cilin të cilin kishte paraqitur të dhëna lidhur me njësorin elektrik, por

nuk ka arrit të gjej se cila banesë ose cili person saktësisht është i lidhur ilegalisht në rrjetin e energjisë elektrike. Ky fakt nuk ishte kontestues ndërmjet palëve, por rrjedh edhe nga procesverbali nr. 03990505 i përpiluar nga punonjësit e Paditësit.

5. Më 10.05.2016 punonjësit e Paditësit konsumatorit L.B. në objektin e banimit kolektiv, llamella A/9 në rrugën Holger Pertersen në Prishtinë së pari ia montojnë njësorin nr. 39700119, e më pastaj në të njëjtën ditë sipas urdhëresës ia ndërrojnë atë njësor me njësorit tjetër nr. 39360867. Këto fakte gjykata i vërtetoi përmes procesverbalit nr. 0589585 dhe nr. 0607728 të dy të datës 10.05.2016, të përpiluar nga punëtorët e Paditësit. Në këtë drejtim gjykata sqaron se, edhe pse të dy procesverbalet janë të së njëjtës ditë dhe nuk e kanë të shënuar orën e përpilimit, megjithatë logjikisht i bie që procesverbali nr. 0589585 të jetë hartuar para procesverbalit nr. 0607728, meqenëse sipas procesverbalit të dytë bëhet ndërrimi i një njësori, i cili figuron i montuar me procesverbalin e parë.
6. Në një datë të pacaktuar Paditësit i kishte dërguar konsumatorit L.B. faturën mujore 07/2016 me shpenzim të energjisë elektrike prej 4,503kWh në shumë prej 295.77€. Paditësi me faturën e lartcekur i kishte faturuar konsumatorit L.B. shpenzimet e energjisë elektrike të shkaktuara në njësorin nr. 39360867 për periudhën kohore, gjatë cilës ai njësor ishte i kyçur ilegalisht në rrjetin elektrik. Ky fakt nuk ishte kontestues mes palëve.
7. Ndaj kësaj fatura konsumatori kishte paraqitur ankesë, ndërsa më 20.02.2017 Departamenti për Konsumator i Paditësit e kishte refuzuar ankesën e konsumatorit. Këto fakte gjykata i vërtetoi përmes pretendimeve ankimore të Paditësit në kundërshtimin e tij me numër 120 të datës 20.01.2020 ndaj vendimit të së Paditurit ZRrE/DMK_V_2013_12_19 të datës 17.12.2019.
8. Konsumatori i pakënaqur me refuzimin nga Paditësit, më 23.08.2017 i është drejtuar Departamentit për Konsumator të së Paditurit me ankesë, i cili përmes vendimit ZRRE/DMK_V_2013_12_19 të datës 17.12.2019 e kishte aprovuar pjesërisht ankesën e konsumatorit L.B., ashtu që e kishte detyruar të Paditurin që ta anuloj faturën nr. 0716210393DPR-... të datës 01.08.2016 në vlerë prej 295.77€, ndërsa ndaj këtij vendimi i Padituri kishte paraqitur kundërshtim. Këto fakte gjykata i vërtetoi përmes vendimit ZRRE/DMK_V_2013_12_19 të datës 17.12.2019 të së Paditurit dhe

kundërshtimit me numër 120 të datës 20.01.2020 të Paditësit nga vendimit të së Paditurit.

9. Përfundimisht i Padituri përmes Bordit të tij më 12.02.2020 e kishte nxjerrë vendimin V_1234_2020 me nr. të protokollit 102/20 të datës 09.03.2020, me të cilin e kishte refuzuar në tërësi ankesën e Paditësit dhe e kishte vërtetuar vendimin ZRRE/DMK_V_2013_12_19 të datës 17.12.2019. I Padituri vendimin e tij e kishte arsyetuar, mes tjerash, se kishte pasur kundërthënie mes provave të evidentuara nga KEDS si dhe pretendimit që njëtori elektrik nr. 39360867 ka qenë i vendosur më herët nga konsumatori L.B., ndërsa pranimin e parë teknik për këtë konsumator vet KEDS e kishte bërë për njëtorin nr. 39700119. I Padituri në vendimin e goditur kishte sqaruar se KEDS nuk e kishte konstatuar banesën ose personin që furnizohet me njëtorin nr. 39360867 me rastin e përpilimit të procesverbalit 0390505 të datës 26.03.2015 me të cilin fillimisht ishte konstatuar lidhja ilegale në rrjetin elektrik.
10. Provat tjera të administruara nga gjykata nuk provuar ndonjë fakt tjerët relevant lidhur me këtë çështje, prandaj gjykata vendosi të mos lëshohet në elaborimin e hollësishëm të tyre.

III. Vlerësimi meritor i rastit

11. Gjukata në rend të parë e shqyrtoi se a ka pasur kompetencë i Padituri për ta dhënë vendimin e goditur dhe gjeti se në bazë të nenit 17 para. 1 nënpara. 1.1 të Ligjit 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë rregullatori harton procedura për zgjidhjen e kontesteve në sektorin e energjisë, përfshirë ankesa nga konsumatorët kundër të licencuarve, në lidhje me shërbimet e ofruara, ndërsa në bazë të nenit 17 të Rregullores për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, Bordi i ZRRE-së është përgjegjës për të vendosur për ankesat ose kontestet që paraqiten pranë tij. Prandaj gjykata erdhi në përfundim se i Padituri ka qenë kompetent për ta dhënë aktin administrativ të goditur. Në këtë drejtim, gjykata vëren se nga Paditësi nuk ishte ndritur asnjë pretendim i kësaj natyre.
12. Gjithashtu, gjykata gjen se procedura që i ka paraprirë nxjerrjes së aktit administrativ të goditur është zbatuar në tërësi sipas rregullova e procedurale të procedurës administrative. Në këtë drejtim, gjykata vëren se nga Paditësi nuk ishte ndritur asnjë

pretendim i kësaj natyre, përveç çështjes së afatshmërisës së ankesës së konsumatorit L.B., për të cila gjykata do të jap sqarime më poshtë.

13. Përveç kësaj, gjykata vëren se i Padituri ka dhënë arsytim të mjaftueshëm për të gjitha çështjet relevante të rastit, si dhe për të gjitha pretendimet e Paditësit, që i ka paraqitur në kundërshtimin e tij. Kështu, nga arsyetimi i aktit administrativ të goditur janë dhënë arsye për çdo pretendim ankimor të Paditësit, duke elaboruar të gjeturat e të Paditurit, si organ kompetent për të vendosur lidhur me kundërshtimin e Paditësit. Gjykata vëren se Paditësi nuk kishte paraqitur pretendim lidhur me arsyetimin e vendimit të goditur.
14. Gjykata gjithashtu konstaton se i Padituri e ka konstatuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, si dhe nga faktet e vërtetuara ka ardhur në përfundimin e drejtë të gjendjes faktike. Në këtë drejtim, gjykata e përkrah qëndrimin e të Padituri si organ administrativ, se Paditësi nuk e ka provuar faktin se njëtori elektrik nr. 39360867, i cili ishte lidhur ilegalisht në rrjetin energjetik, e ka furnizuar banesën ose ndonjë hapësirë të tjetër të konsumatorit L.B., ose është shfrytëzuar në ndonjë mënyrë nga ky konsumator. Në procesverbalin përkatës vetëm ishte konstatuar se ai njëtor është i lidhur ilegalisht në rrjetin elektrik, pa specifikuar se cila banesë ose objekt është duke u furnizuar nga ai njëtor ose cili person është i kyçur në rrjet përmes atij njëtori. Përveç kësaj, vet Paditësi së pari ia kishte montuar konsumatorit L.B. njëtorin nr. 39700119 me pëlqim elektro energjetik, ndërsa më 10.05.2016 atë njëtor e kishte ndërruar me njëtorin nr. 39360867 në bazë të urdhëresës. Fakti që konsumatorit L.B. nga zyrtarët e Paditësit më vonë i është montuar njëtorin nr. 39360867, i cili më herët ishte konstatuar se ishte i lidhur ilegalisht pa specifikime për banesën ose personi, për këtë gjykatë nuk nënkupton se konsumatori në fjalë ka qenë i lidhur në rrjetin energjetik përmes atij njëtori pa pëlqim elektro energjetik. Kjo për faktin se këto veprime nuk janë të mjaftueshme për ta krijuar lidhjen ndërmjet konsumatorit në fjalë dhe njëtorit nr. 39360867, sidomos duke e marrë parasysh faktin se ky njëtor është montuar me urdhëresë e jo me kërkesë të konsumatorit, si dhe Paditësi paraprakisht i kishte dhënë konsumatorit në fjalë pëlqimin që të lidhet në rrjetin energjetik përmes njëtorit nr. 39700119.
15. Meqenëse nuk ka prova që e lidhin konsumatorin L.B. me shpenzimin e energjisë elektrike të regjistruar nga njëtori nr. 39360867, atëherë edhe faturimi i shpenzimit ka qenë i jashtëligjshëm, pavarësisht për cilën periudhë kohore.

16. Gjykata e gjen të pabazuar pretendimin se Paditësit ankesa e konsumatorit të lartcekur ndaj vendimit të Paditësit me të cilin ia kishte refuzuar ankesën atij ka qenë e pas afatshme, meqenëse në shkresat e lëndës nuk ka prova e kur konsumatori L.B. e ka pranuar atë vendim. Sipas nenit 13 para. 1 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej katërbëdhjetë (14) ditësh kalendarike nga data e pranimi të vendimit apo nga data kur afati përfundimtar për shqyrtim të ankesës nga furnizuesi ka kaluar, siç përcaktohet në nenin 9, paragrafi 3, të asaj rregulle. Meqenëse Paditësit kishte nxjerrë vendim, atëherë si moment i fillimit të rrjedhjes së afatit për parashtrimin e ankesës mund të merret vetëm dita kur konsumatori e ka pranuar atë vendim, ndërsa situata nga neni 9 para. 3 i rregullores së lartcekur nuk mund të zbatohet.
17. Prandaj gjykata përfundimisht vlerëson se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, rrjedhimisht duhet të refuzohet. Për këto arsye, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Komerciale e Kosovës

Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.306/2022

Gjyqtari

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktgjykimit mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimi. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.